



FEDERATA E HENDBOLLIT E KOSOVËS
KOSOVA HANDBALL FEDERATION
RUKOMETNI SAVEZ KOSOVA

EDICIONI 2025/26

PROPOZICIONET E KUPËS SË REPUBLIKËS SË KOSOVËS

Federata e Hendbollit e Kosovës
10000 Pristina, Republic of Kosovo
Tel: +383 38 248 758
Mob: +383 44 508 996
Email: kg@kosovahandball.info
Web: www.kosovahandball.info

- 1.1. Në bazë të nenit 6 pika alineja e 5-të e Statutit të FHK, në mbledhjen e vet të mbajtur më 06.07.2025 Bordi i FHK-së miratoi:

Propozicionet e garave për Kupën e Republikës së Kosovës për edicionin garues 2025/26.

- 1.2. Me këto dispozita përcaktohet sistemi i garave për Kupë. Rregullorja e garave, kalendari, shpenzimet e garave, mënyra e paraqitjes, tërheqja e shortit, ankesat dhe gjithë ato veprime që do të bëhen në lidhje me garat për Kupë.
- Federata e Hendbollit e Kosovës është organizatore e garave për Kupë, në konkurrencën e meshkujve dhe të femrave.
- Me gara udhëheq Komisari i garave (KG i zgjedhur edhe për ndeshet e Kampionatit)
- 1.3. Skuadrave fituese të finales së Kupës u jepen Kupat dhe medaljet.
- 1.4.1 Skuadrat fituese të Kupës së Republikës së Kosovës automatikisht fitojnë të drejtën e pjesëmarrjes në garat e European Cup.
- Në rastet kur fituesi i Kampionatit dhe Kupës është e njëjta skuadër, atëherë finalisti i kupës fiton të drejtën e paraqitjes në garat e European Cup.
- E njëjta Rregullore vlen edhe për Superkupën.
- 1.4. Garat për Kupë udhëhiqen në bazë të dispozitave të Rregullores mbi organizimin e garave të hendbollit, Propozicionet e garave për Kupë dhe me Rregulloret e tjera të FHK-së.
- 1.5. Në garat për Kupë në mënyrë obliguese marrin pjesë ekipet që bëjnë gara në Superligën e meshkujve dhe femrave si dhe Liga e parë për meshkuj dhe femra.
- Pjesëmarrës i garave të Kupës së Kosovës është çdo skuadër që vepron dhe është nga territori i Kosovës.
- 1.6. Skuadra që nuk merr pjesë do të ndëshkohet me marrjen e 5 pikëve nga fondi që ka në garat e rregullta të Kampionatit 2025/26.
- 1.7. Paraqitja e skuadrave dhe tërheqja e shortit bëhet më së paku 15 ditë para fillimit të garave, fillimin e të cilave e cakton Komisari i garave.

Rethi	Shorti	Ndeshja zhvillohet
Eliminueset		22/23.10.2025
Rrethi i parë		19/20.11.2025
Çerekfinalet		25/26.03.2026
Gjysmëfinalja		25.04.2026
Finalja		26.04.2026

- 1.8. Të drejtën e paraqitjes në ndeshjet në garat për Kupë e gëzojnë të gjithë lojtarët-lojtaret e regjistruar-a në bazë të Rregullores mbi regjistrimin e lojtarëve për vitin garues 2025/26.
- Lojtari i cili regjistrohet në afatin e rregullt kalimtar të korrikut apo mini afatin e janarit ka të drejtë paraqitje pa marrë parasysh se a ka zhvilluar ndeshje për ndonjë ekip tjetër gjatë edicionit të Kupës së Kosovës 2025/26.

Nëse për ndonjërin ekip paraqitet lojtari-ja që më parë nuk është regjistruar, ekipi i tij e humb ndeshjen me rezultat zyrtar 10:0.

- 1.9. Garat për Kupë zhvillohen në sistem të mënjanimit (eliminimit). Të gjitha ndeshjet zhvillohen sipas rregullave ndërkombëtare të lojës së hendbollit.
- 1.10. Xhiroja e parë e garave për Kupë është e dirigjuar. Zhvillohet vetëm nga një ndeshje, skuadra vendas e përcaktohet nga Komisioni i garave sipas shortit të dirigjuar.
- 1.11. Pagesa e personave zyrtarë në ndeshjet eliminuese dhe ndeshjet çerekfinale bëhet nga FHK-ja.
- 1.12. Në xhirot vijuese bëhet tërheqja e shortit. Ndeshjet e rrethit eliminuese dhe çerekfinale zhvillohen vetëm nga një ndeshje, skuadra vendase tërhiqet me shorti.
Katër skuadrat e renditura në Kampionatin 2025/26, në katër vendet e para do të jenë bartës të grupeve deri në ndeshjet gjysmëfinale.
- 1.13. Fitues do të jetë skuadra i cili ka shënuar fitore. Nëse ndeshja përfundon me rezultat të barabartë fituesi përcaktohet me ekzekutimin e 7m.
- 1.14.1 Para se të ekzekutohen 7 m, secili ekip duhet ti emëroj pesë lojtarë të cilët kanë të drejtë të luajnë duke ia dorëzuar gjyqtarit listën e numrave. Këta lojtarë duhet të ekzekutojnë nga një gjuajtje, duke ja kaluar rendin lojtarëve kundërshtarë. Secili ekip është i lirë të vendosë rendin me të cilin lojtarët do ti ekzekutojnë gjuajtjet e tyre.
- 1.14.2 Portierët mund të seleksionohen nga lista dhe të zëvendësohen në përputhshmëri me Rregullat e lojës. Portierët mund të ekzekutojnë gjuajtje dhe gjuajtësit mund të luajnë si portierë.
- 1.14.3 Gjyqtarët zgjedhin portën në të cilën do të ekzekutohen gjuajtjet. Zgjedhja e ekipit për të ekzekutuar gjuajtjen e parë bëhet në bazë të shortit. Ekipi që fiton shortin mund të zgjedh nëse dëshiron të ekzekutoj i pari apo i fundit.
- 1.14.4 Nëse shënimet janë të barabarta pas rrethit të parë, ekzekutimi i 7 m duhet të vazhdoj përderisa nuk të arrihet vendimi (fitorja e njërit skuadër).
- 1.14.5 Rrethin e dytë duhet ta filloj skuadra kundërshtarë. Përsëri duhet të caktohen pesë lojtarë që kanë të drejtë të luajnë (lojtarët e emëruar më parë mund të emërohen përsëri). Në rrethin e dytë arrihet vendimi me ndryshimin në diferencën e golave pasi që të dyja ekipet kanë ekzekutuar nga një gjuajtje. Pas 5 gjuajtjeve përsëri duhet të emërohen 5 lojtarë të cilët kanë të drejtë të luajnë (lojtarët e emëruar më parë mund të emërohen përsëri) por ndeshja mund të përfundoj pas ekzekutimeve të para. Rradha e gjuajtes në raundin e dytë kalon tek skuadra e dytë.
- 1.14.6 Lojtarët dhe portierët me të drejtë loje janë lojtarët që në raportin e ndeshjes nuk janë të pezulluar, shkualifikuar apo përjashtuar.
- 1.14.7 Shkeljet serioze gjatë ekzekutimit të 7 m do të sanksionohen me shkualifikim. Nëse ekzekutuesi është shkualifikuar apo lënduar duhet të zëvendësohet me një lojtarë shtesë.
- 1.14.8 Derisa bëhet ekzekutimi i gjuajtjeve, vetëm ekzekutuesi, portieri aktual dhe gjyqtari mund të gjenden në gjysmën përkatëse të fushës.
- 1.14.9 Nëse numri i lojtarëve me të drejtë loje është më pak se 5, atëherë një lojtarë mund të emërohet për të ekzekutuar gjuajtjen për herë të dytë në të njëjtën rreth.
- 1.14.10 Nëse edhe pas ekzekutimit të 7 m të dy rrethëve rezultati mbetet baras prapë duhet të emërohen 5 lojtarë por që ndeshja mund të përfundoj pas ekzekutimeve të para.
- 1.14. Për kohën dhe vendin e zhvillimit të lojës vendësit janë të obliguar të lajmërojnë Komisararin e garave, ekipin mysafir, vëzhgues-kontrolluesin, gjyqtarët së paku 48 orë para zhvillimit të ndeshjes. Mos përmbushja e këtij obligimi sanksionohet me përgjegjësitë e Rregullores disiplinore dhe dënimin me gjobë prej 100 €.
- 1.15. Detyrat e vëzhgues-kontrolluesit dhe të gjyqtarëve janë të njëjta si në ndeshjet e kampionatit.
- 1.16. Nëse skuadra nuk paraqitet fare në ndeshje, ai do të dënohet me 200 € dhe do të eliminohet nga garat e më tutjeshme si dhe kompensimin e shpenzimeve të skuadrës rivale.

- Nëse skuadra ne ndeshjet e pjesës finale nuk e zhvillon ndeshjen, do te gjobitet me 2,000 euro ne konkurrencën e meshkujve dhe 1,000 euro ne konkurrencën e femrave dhe do tu merren nga 5 pikë për edicionin e garave 2026/27.
- 1.17. Ndeshja regjistrohet nga KG-ja me rezultat zyrtar 10:0 në bazë të procesverbalit dhe deklaratave të personave zyrtarë në këto raste:
- 1.18.1 Nëse skuadra nuk ka udhëtuar pa arsye;
- 1.18.2 Nëse fusha nuk është përgatitur me fajin e vendësit (mikpritësit)
- 1.18.3 Nëse skuadra është paraqitur me lojtarë që nuk janë të regjistruar në mënyrë të rregullt, licencuar, janë të dënuar ose pezulluar (suspenduar);
- 1.18.4 Nëse skuadra paraqitet me lojtarë të cilëve u ka kaluar kontrollimi mjekësor apo nuk ka fare kontroll mjekësor;
- 1.18.5 Nëse vendësi nuk e ka siguruar mjekun e licencuar në ndeshje;
- 1.18.6 Nëse nuk e dokumenton se ka bërë kërkesë për sigurimin e ndeshjeve në PK -së.
- 1.18. Përveç që ndeshja do të regjistrohet me rezultat zyrtar 10:0, skuadra automatikisht eliminohet nga garat e mëtejshme në këto raste:
- 1.18.1. Nëse skuadra e dorëzon ndeshjen ose ndeshja nuk zhvillohet me fajin e tij.
- 1.18.2. Nëse skuadra e lëshon fushën ose nuk mundëson vazhdimin e lojës së filluar.
- 1.18.3. Nëse skuadra kundërshtar nuk pranon të zhvillojë ndeshjen për shkaqe të paarsyeshme
- 1.18.4. Nëse me fajin e skuadrës ndërpritet ndeshja.
- 1.18.5. Nëse ndeshja ndërpritet, për shkak të sulmit fizikë ndaj personave zyrtar apo skuadrës kundërshtar.
- 1.19. Ankesat për garat për Kupë duhet të paralajmërohen më së voni 15 minuta pas përfundimit të ndeshjes.
- 1.20.1 Arsyetimi i ankesës duhet të dërgohet në KG më së largu 12 orë pas përfundimit të ndeshjes.
- 1.20.2 Ankesës në ndeshjen për Kupë duhet t'i bashkëngjitet edhe shuma e mjeteve të paguara prej 100 €.
- 1.20.3 Kjo shumë e mjeteve i paguhet vëzhgues-kontrolluesit menjëherë pas përfundimit të ndeshjes, ndërsa vëzhgues-kontrolluesit janë të obliguar që këtë ta shënojnë në protokollin e ndeshjes dhe të konstatojnë se është paraqitur ankesa dhe janë përmbushur obligimet në mbështetje të alinesë 2 të këtij neni.
- 1.20.4 Ankesa në ndeshjet e Kupës së Kosovës i dorëzohet Komisionit të garave në afat prej njëzetekatër (24) orëve pas përfundimit të ndeshjes.
- 1.20.5 Vendimi mbi ankesën në shkallën e parë merret në afat prej njëzetekatër (24)orëve dhe ju dorëzohet palëve me shkrim.
- 1.20.6 Në këtë vendim, pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në organin e shkallës së dytë – Këshillin e Ligës në afat prej dymbëdhjetë (12) orëve, i cili vendim do të merret në afat prej njëzetekatër (24) orëve.
- 1.20. Në ndeshjet gjysmëfinale të Kupë Republikës së Kosovës shpenzimet e personave zyrtarë dhe shpenzimet e tjera kompensohen nga nga Federata. Ndeshjet finale personat zyrtarë (gjyqtarët dhe vëzhgues-kontrolluesi) do ti gjykojnë pa kompensim, për nder dhe respekt të finales Kupës së Republikës së Kosovës.
- 1.21. Ndeshjet e pjesës finale (ndeshjet gjysmëfinale dhe finale) të Kupës së Kosovës në dy konkurrencat zhvillohen në Prishtinë. Nëse ka ndonjë interes të promovimi të hendbollit Bordi mund të merr vendim që ndeshjet e pjesës finale të zhvillohen edhe në një qendër tjetër sipas kushteve të shpallura sipas nenit 1.23.
- 1.22. Organizimin e ndeshjeve të pjesës finale, Bordi i FHK-së mund t'ia besojë edhe ndonjëres prej organizatave të hendbollit, klubeve nën kushtet që do të parashtrorë paraprakisht Bordi dhe për këtë do të lidhet kontratë ndërmjet Bordit të FHK-së dhe organizatorit.
- Nëse Bordi i FHK-së vendos që organizimin e ndeshjeve të pjesës finale të Kupës në të dy konkurrencat t'ua besojë subjekteve si në alinenë paraprake, do të shpallë Tenderin dhe në njërin nga Buletinet e FHK-së, para fillimit të garave për Kupë dhe më së largu tridhjetë (30) ditë para se të zhvillohen ndeshjet gjysmëfinale do t'i lajmërojë klubet, organizatat e ndryshme sportive apo të marketingut mbi kushtet që duhet t'i plotësojnë nëse dëshirojnë të marrin organizimin. Dhe në bazë të ofertës që i paraqesin Bordit me shkrim, Bordi vendos në bazë të kushteve më të mira se kujt do t'ia besojë organizimin. Organizatat e ndryshme sportive apo të marketingut , klubet që e fitojnë tenderin e organizimit duhet së paku 15 ditë para

zhvillimit të ndeshjeve të pjesës finale (gjysmëfinale dhe finale) ti deponojnë mjetet sipas kontratës në konton e FHK-së. Në të kundërtën e humbin organizimin.

- 1.23. Skuadra fituese së ne konkurrencën e meshkujve përveç Kupës së FHK- dhe medaljeve të arta nga FHK-ja do te shpërblehet nga FHK-ja edhe me një shumë prej 4,000 €.
Skuadra finaliste shpërblehet me medalje të argjendi.
- 1.24. Skuadra fituese së ne konkurrencën e femrave përveç Kupës së FHK- dhe medaljeve të arta nga FHK-ja do te shpërblehet nga FHK-ja edhe me një shumë prej 2,500 €.
Skuadra finaliste shpërblehet me medalje të argjendi.
- 1.25. Çështjet të cilat nuk janë përfshirë me këto Propozicione, do të rregullohen sipas Propozicioneve të garave si dhe akteve tjera normative të FHK-së.
- 1.26. Interpretimin e këtyre propozicioneve e bënë Bordi i FHK-së.

BORDI I FHK-së
EDIN KOLGECI d.v.
President